

VENDIM
Nr. 176, datë 25.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 28, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas nënpikës 1.2., të vendimit nr. 28, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet nënpika 1.3., me këtë përmbajtje:

“1.3. Përfashtimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH-së, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjetesh t’i realizojnë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama